



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-2017/04

Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore dhe duke u bazuar në nenin 3, paragrafin 2, pika 6 dhe 11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM miraton këtë:

RREGULLORE PËR BARTJEN E DETYRUESHME TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIOVIZUALE NË OPERATORIN E MULTIPLEKSIT

NENI 1 QËLLIMI

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për bartjen e detyrueshme të ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorit të multipleksit, me qëllim të sigurimit të qasjes në ofruesit e shërbimeve mediale për të gjithë përdoruesit në baza transparente, objektive dhe jo-diskriminuese, në përputhje me standardet e përgjithshme të pranura në Bashkimin Evropian si dhe të promovojë konkurrencën në fushën e shërbimeve audiovizuale, në mënyrë që publikut t'i ofrohen shërbime me kualitet të lartë dhe teknologji të avancuar.

NENI 2 FUSHËVEPRIMI

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen ndaj të gjithë të Licencuarve të KPM-së të cilët operojnë si operatorë të multipleksit.

NENI 3 PËRKUFIZIMET

1. **Bartja e detyrueshme** – obligimi për operatorin e multipleksit lidhur me bartjen e detyrueshme të ofruesve të shërbimeve mediale të licencuara nga KPM.

2. **Operatori i multipleksit** – personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore të programeve dixhitale dhe shërbimet suplementare për transmetimin dixhital të të dhënave.
3. **Multipleksi** – një set i standardizuar i sinjaleve dixhitale, i shprehur në Mbit/s (Mega-bit-për-sekondë), që përmban disa programe televizive dhe/ose të radios dhe/ose të dhëna të tjera, të cilat transmetohen dhe emetohen në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të thurur.
4. **Ofruesi i shërbimit medial (OSHM)** – personi fizik apo juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të ofruesit të shërbimit medial dhe për përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
5. **Licencë** – leja e dhënë nga KPM-ja për operatorin e multipleksit për të ushtruar aktivitet transmetimi në Republikën e Kosovës.
6. **I Licencuar** - personi juridik i licencuar nga KPM për të vepruar si operator i multipleksit.

NENI 4

BARTJA E DETYRUESHME E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE

1. Me qëllim të sigurimit të qasjes së publikut në ofruesit e shërbimeve mediale, që ofrojnë përmbajtje programore në interes të përgjithshëm, dhe në mënyrë që të promovohet pluralizëm medial, të Licencuarit i nënshtrohen obligimit për bartje të detyrueshme.
2. Të Licencuarit si operatorë të multipleksit në nivel shtetëror obligohen që, në pajtim me nenin 18, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore, të përfshijnë në multipleks dy programet e transmetuesit publik në afat të pacaktuar dhe dy kanalet (komerciale) me mbulim shtetëror të licencuara nga KPM për transmetim tokësor deri në përfundimin e afatit të Licencës.
3. Të Licencuarit si operatorë të multipleksit në nivel rajonal obligohen që, në pajtim me nenin 18, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio-difuzive Tokësore, të përfshijnë në multipleks të gjitha kanalet rajonale dhe lokale të licencuara nga KPM për transmetim tokësor, në pajtim me politikat strategjike të KPM-së.
4. Bartja e detyrueshme e ofruesve të shërbimeve mediale nuk nënkupton qasje pa pagesë në MUX.
5. KPM do të përpilojë për të Licencuarin listën e kanaleve me statusin e bartjes së detyrueshme për MUX shtetëror dhe regjional.

NENI 5 RAPORTIMI

1. Operatorët e multipleksit duhet të raportojnë në KPM lidhur me aspektet e punës që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Rregulloreje.


2. Operatorët e multipleksit obligohen që të njoftojnë me shkrim KPM-në lidhur me përfshirjen e kanaleve me statusin e bartjes së detyrueshme.

**NENI 6
SANKSIONET**

Për shkelje të kësaj Rregulloreje KPM do të ndërmarrë masat ligjore të përcaktuara me Ligjin për KPM-në Nr. 04/L-44 dhe Ligjin për Dixhitalizim Nr. 05/L-027.

**NENI 7
HYRJA NË FUQI**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



25.01.2017

Data